



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/OPSTINA STIMLJE/MUNICIPALITY  
SHTIME

Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Mayor's office

<b>Data/Datum/Date:</b>	25. 6. 2020
<b>Nr/Br/No:</b>	02/ 256
<b>Për/Za/To:</b>	Qytetarët e komunës së Shtimes
<b>Nga/Od/From:</b>	Kryetari i Komunës, Naim Ismajli
<b>Lënda/Predmet/Subject:</b>	PROCESVERBAL I DEBATIT PUBLIK ME QYTETARË

Në përputhshmëri me nenin 68.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 14,18 dhe 22 të Statutit të Komunës së Shtimes për Takimet me Publikun, i mbajtur me datë 22 . 6. 2020 Në Shtëpinë e Kulturës, kryetari i Komunës nxjerrë këtë:

**EKSTRAKT  
PROCESVERBAL**

Konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në Shtëpinë e Kulturës në Shtime, kryetari i komunës së Shtimes, Naim Ismajli ka mbajtur mbledhjen publike me qytetarë,

**Kryetari i Komunës, Naim Ismajli:** Pasi përshëndeti të pranishmit në sallë prezantoi rendin e ditës:

1. Informatë për situatën rreth pandemisë covid-19 në komunën e Shtimes,
2. Prezantimi i Raportit gjashtë-mujor për vitin 2020
3. Korniza Afatmesme Buxhetore 2021 -2023.

**Kryetari i Komunës, Naim Ismajli:** Fillimisht foli për një informatë të përgjithshme rreth aktiviteteve që janë ndërmarrë në parandalimin e sëmundjes ngjitëse Covid 19, pastaj ka dhënë një raport gjashtëmujorë të punëve të kryera dhe të cilat janë duke u kryer në komunën tonë si dhe për fund ka folur rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2021-2023.

Kryetari Ismajli fillimisht foli për themelimin e Shtabit Emergjent dhe pesë nënshtabeve për menaxhimin e situatës pas shfaqjes së pandemisë nga sëmundja Covid 19. Ai tregoi se në komunën tonë kanë qenë 18 raste dhe janë shëruar të gjithë, ndërsa mbrëmë është lajmëruar një rast i ri me Covid 19, mirëpo gjendja e pacientit është stabile dhe çdo gjë është nën kontrollë.

Gjithashtu Ismajli njoftoi se sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) më nuk do të ketë teste për pa pasur simptoma lidhur me këtë sëmundje. Gjatë gjithë

kohës kemi qenë të fokusuar për parandalimin e përhapjes së sëmundjes vdekjeprurëse, pastaj kemi ndihmuar familjet që kanë pasur nevojë duke ju shpërndarë pako ushqimore dhe higjienike, tha kryetari Ismajli. Me një fjalë, ka qenë një mobilizim i përgjithshëm i qytetarëve që kanë ndihmuar lidhur me mospërhapjen e sëmundjes, mirëpo Ismajli tha se tash nuk duhet të qëndrojmë komodë por gjithnjë duhet pasur kujdes sepse ende ekziston rreziku për përhapjen e kësaj sëmundje të rrezikshme të shekullit 21.

Në vazhdim, kryetari Ismajli foli rreth punëve gjashtëmujore që janë kryer dhe fazës së punimeve që janë duke u kryer. Ai tha se brenda këtij gjashtëmujori kemi pasur sfida për implementimin e projekteve me kohë për shkak të pandemisë mirëpo asnjë projekt deri më tash nuk ka dështuar dhe në muajt e ardhshëm do të kryhen projektet e planifikuara për vitin 2020.

Ndërkaq sa i përket planifikimit të buxhetit tha se kemi filluar punën me grupet e interesit dhe kjo do të jetë një bazë e mirë për vitin tjetër lidhur me projektet infrastrukturës duke përfshirë rrugët, kanalizimet, trotuare, sheshe, mirëmbajtje të shkollave, pastaj projekte për zhvillim ekonomik, ambient e të tjerë.

Në kuadër të kësaj mbledhje pati edhe pyetje nga qytetarët:


**Resul Gashi:** pyeti lidhur me objektin e ri shkollor në Pjetërshticë se a do të fillojnë nxënësit mësimin në këtë godinë të re më 1 shtator, për të cilën kryetari Ismajli tha se në bazë të planit dinamik ne planifikojmë që të fillojmë vitin e ri shkollor në objektin e ri. Ndërsa qytetari,

**Behadin Rexhepi:** pyeti lidhur me lehtësirat që do të kenë bizneset si dhe rreth kanalizimit për ujëra të zeza si dhe ndërtimin e një impianti. Ndërsa,

**Liman Muhadini:** pyeti lidhur me punimet e rrugës që janë duke i zhvilluar nga varrezat e Lagjes së Pajtimit deri te xhamia e fshatit.


Kryetari Ismajli, për të gjitha pyetjet dha sqarime veç e veç.

Pasi që pyetje tjera nuk kishte, bledhja përfundoi në ora 17:00



---

Adresa: Rruga "Tahir Sinani", Nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.  
Tel.: +383290389016, e-mail: info@shtime-komuna.org



---

Adresa: Rruga "Tahir Sinani", Nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.  
Tel.: +383290389016, e-mail: info@shtime-komuna.org



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E SHTIMES

Lista e pjesëmarrësve në Diskutimin Publik të Kryetarit 22. 6. 2020

Nr.	Emri dhe mbiemri	Detyra	Nr. i telefonit	E-mail adresa	Nënshkruaj
1	HAVE GARRI	Direktor	044-300-164	havgarrif@rks-gov.net	<i>[Signature]</i>
2	Kimete Ungj	ZKF	044/4361455	kimete.ungj@rks-gov.net	<i>[Signature]</i>
3	FATMIR REXHEPI	ZYRTAR ODPUKGO	04519061365	fatmir.r.rexhepi@rks-gov.net	<i>[Signature]</i>
4	FITIM HORHA	DREKTOR DZHE	049824848	fitim.horha@rks-gov.net	<i>[Signature]</i>
5	FATMIR ZYMERI	ZYR. DKA	044-20568	fatmir.zymeri@rks-gov.net	<i>[Signature]</i>
6	Ylman Muhadin	L.Pajtimit	044-915924		<i>[Signature]</i>
7	HENEZ TASHANI	DSHP	049-999162	henez.tashani@rks.gov.net	<i>[Signature]</i>
8	MUSE BAKTU	DSHMS	044 205 663	musa.sh.kubacki@rks-gov.net	<i>[Signature]</i>
9	BETHADILI REXHEPI	KBSSH	044 205 882	bethadili@rks-gov.net	<i>[Signature]</i>
10	Lulzim Shiti	ZIP	044/201-984	lulzimshiti@hotmail.com	<i>[Signature]</i>
11	FIDAN SHAQIRI	Drejtor shkolle	044-600147	fidan-shaqiri@hotmail.com	<i>[Signature]</i>
12	Resul Gashi	Qendru Rinore	044 718 657	gashiresul@gmail.com	<i>[Signature]</i>
13	FATLUM REXHAJ	DSHMS	044-981-504	fatlum.rexhaj@hotmail.com	<i>[Signature]</i>
14	Bejor Osmani	KRYETAR LAKHJA V	044-116-486	Bejor.Osmanik@qemriteca.com	<i>[Signature]</i>
15	Alban Rashizi	Kryetar Fshati	045-611-414		<i>[Signature]</i>
16	Bashkim Selmanaj	Qytetar	044-111576		<i>[Signature]</i>
17	Gazmend Ademi	Zyrtar info	044-400089	gazmend.ademi@rks-gov.net	<i>[Signature]</i>
18					
19					
20					
21					




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/OPSTINA STIMLJE/MUNICIPALITY  
SHTIME

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Data/Datum/Date:	23. 6. 2020
Nr/Br/No:	09/18_____
Për/Za/To:	Zyrën e Kryetarit, z. Naim Ismajli
Nga/Od/From:	Fatmire Ferati - përgjegjëse në DKRS
Lënda/Predmet/Subject:	PROCESVERBAL



Në përputhshmëri me nenin 68.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 14,18 dhe 22 të Statutit të Komunës së Shtimes për Takimet me Publikun, i mbajtur me datë 22 . 6. 2020 nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, kryetari i Komunës nxjerrë këtë:

**EKSTRAKT  
PROCESVERBAL**

**Procesverbali nga debati publik me OJQ-të dhe Klubet Sportive për Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore -KAB 2021 – 2023 në Komunën e Shtimes.**

**Drejtori Lumni Amrushi:** Përshëndeti të pranishmit duke i falënderuar për pjesëmarrje dhe njëkohësiht duke i njoftuar me qëllimin e debatit dhe njëkohësisht duke ia kaluar fjalën zyrtares kryesore financiare znj. Kimete Ukaj.

**Kimete Ukaj:** I njoftoi të pranishmit për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023 (KAB), për buxhetin total të Komunës së Shtimes, për projektet kapitale në përgjithësi e në veçanti për buxhetin e DKRS-ës dhe për subvencionet, duke iu dhënë hapësirë të pranishmëve të paraqesin idetë, kërkesat dhe projektet e tyre për periudhen tri vjeçare.

**Resul Gashi -Qendra Rinore Publike-Shtime:** Përshëndetje për të gjithë, unë propozoj që në kuadër të buxhetit të DKRS-ës të ndahet një fond për themelimin e një grupi punues nga të gjitha OJQ-të për hartimin e një plani të aktiviteteve të përbashkëta dhe realizimin e tyre .

**Faton Imeri-KHF"VJOSA":** Përshëndetje për të gjithë, faleminderit për ftesen, unë kërkoj nga të gjitha klubet sportive të bëjnë një parallogari për vitin e ardhshëm se sa kanë nevojë klubet për

përkrahje nga komuna duke bërë planifikimin me kohë. Po ashtu kërkoj të shikoni mundësinë buxhetore për një transport nga qyteti ( apo pika zero) deri te palestra sepse po kemi vështirësi të vazhdueshme të gjitha klubet sportive që veprojnë në palestër.

**Nesret Salihaj-Klubi i Boksit “Skender Salihaj”:** Me sa e kuptove që total buxheti i komunës qenka 7.670.665 për vitin 2021, sa do të jetë shuma e subvencioneve në DKRS?

Kam disa kërkesa, të bëhet inventarizimi i palestrës sportive në Shtime, gjithashtu të shohim mundësin për blerjen e paisjeve për sportin e boksit dhe të kikkoksit sepse janë paisje profesionale dhe shumë të nevojshme për klub kur dihet se ne kemi sportist që garojnë në arenën ndërkombëtare. Po ashtu kërkoj të futet në projekt edhe mirëmbajtja e palestrës dhe të sigurohet një transport.

**Gazmend Zeqa- KF “VJOSA”:** Përshëndetje për të pranishmit dhe faleminderit për ftesën, ne si klub i futbollit kemi kërkesë që të futet në buxhet rregullit dhe zgjerimi i zveshtoreve te stadioni i qytetit sepse hapsira egzistuese është e pamjafueshme dhe nuk i pletëson kushtet që kërkohen nga FFK dhe UEFA, kjo kërkesë është primare por edhe pjesa e tribunave dhe rrethojës nëse është mundësia të rregullohen me një projekt, kur dihet se ne tani jemi në një nivel pak më të lartë të garave!

**Ramiz Smajli- Klubi i KIK-BOKSIT:** Përshëndetje për të gjithë, faleminderit për ftesën në këtë takim shumë të qëlluar. Ne si klub i kik-boksit kemi një kërkesë për sigurimin e paisjeve profesionale për kik-boks që duhet të kemi për përgatitjen e sportistëve kur dihet se ne kemi tani dy sportist – kik-boksier që do të përfaqësojnë Kosovën në arenën ndërkombëtare. Gjithashtu kërkojmë që të ndahet një buxhet nga subvencionet apo kategorit tjera buxhetore për organizimin e kampingjeve për sportistës dhe talentët e rinjë.

**Nesret Rexhepi-KH”VJOSA”(M):** Faleminderit për ftesën dhe mundësinë që po na e jepni për të debatuar. Ne si klub kemi disa kërkesa përveq buxhetit ne kemi edhe një kërkesë për rregullimin e hapsirave administrative -zyre që besoj këtë kërkesë e kan edhe klubet tjera sepse kemi nevoj për këto zyre. Gjithashtu në kuadër të buxhetit -subvencioneve të klubeve të shohim mundësinë për rritje të buxhetit për trajnime profesionale për trajner.

**Bekim Shahini-Klubi i Futsallit “VJOSA”:** Përshëndetje për të gjithë, buxheti i DKRS-ës prej 33.500.00 qenka shumë i mangët duke marr parasysh numrin e klubeve dhe ojq-ve rinore, kërkoj që të rritet buxheti në kategorinë e subvencioneve por edhe në kapitale.

**Gazmend Zeqa- shoqata sportive “VJOSA”:** Ne si shoqat jemi mundu me i përkrah të gjitha klubet që kan qenë në themelim e sipër, por edhe përkrahje e komunës duhet të jetë si në aspektin financiar po ashtu edhe në aspektin e infrastrukturës sportive.

**Resul Gashi -Qendra Rinore Publike-Shtime:** A egziston mundësia që thirrja publike për subvencione të bëhet sipas fushave, të ndahet veç e veç psh: për kulturë veç, për sport veç dhe për rini veç. Po ashtu kam një kërkesë për krijimin e hapsirave për aktivitetet e të rinjëve a është

mundësia të futet një projekt në kuadër të buxhetit për vitin 2021-2023, për ndërtimin e një objekti për aktivitetet rinore.

**Artan Rrafshi- përfaqësues i të rinjëve :** Kërkojë nga drejtoria që fushat e basket dhe streetballit të bëhen funksionale dhe të vendosen koshat, sepse ne po detyrohemi të shkojmë nëpër fshatra për të luajtur basketboll.

**Lumni Amrushi-drejtore në DKRS-** Pas diskutimeve nga përfaqësuesit e klubeve dhe ojq-ve rinore iu përgjigj pyetjeve të parashtruara dhe pas kësaj i falenderoi të gjithë për pjesëmarrje dhe për kontributin e dhënë gjatë këtij debati.

Takimi përfundoi në ora 14:55.

Procesverbalin e mbajti: Fatmire Ferati \_\_\_\_\_





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E SHTIMES

Lista e pjesëmarrësve 22. 6. 2020

DKRS

Nr.	Emri dhe mbiemri	Detyra	Nr. i telefonit	E-mail adresa	Nënshkruaj
1	BEKIM SHAHINI	KRYETAR FUTJALL	044-205308	BEKIM.SHAHINI@shimes.gov.km	
2	ZENEL SARBANI	PERFADOSH VETERANUS	044-122083	ZENEL.SARBANI@shimes.gov.km	Zhogar
3	SKENDER ADEMAJ	PERFADOSH K.K.VJOSA II	044-201-851	redmex-sa@hotmail.com	Adem
4	NYRET REXHEPI	SEKRETARI K.H.VJOSA (17)	049/106-111	khm.vjosa@gmail.com	Retra
5	EREMAL BAFTIU	KRYETAR AUTO KLUBI "VJOSA"	049/201-910	ak.vjosa@gmail.com	Baftiu
6	GËZIM DELIU	KRYETAR SHBA G.1 SHTRITIT	044-347196	shba-gurichrejt@hotmail.com	Deliu
7	BUJAR OSTIANI	Drejtor Financore KFV	044-116-456	Bujar.Osmarks@gmail.com	Bujari
8	Gazmend Zega	Sekretar KF-Vjosa	044 260 553	FC.Vjosa@gmail.com gazmend.zega@msn.com	Zega
9	Artan Rafshiqi	—	045-206-445	artanrafshiqi2@gmail.com	ARR
10	Frason Imeri	DREJTOR BORZIT	044-206067	KH.VJOSA.GMAI	Imeri
11	Sami Januzi	SEKRETAR BORZIT	044 205-977	KB "Vjosa"	Januzi
12	Ramir Smajli	SEKRETAR I KLUBIT KICK BOXS	044 166 144	smajli67@hotmail.com	Smajli
13	Nesret Salihaj	TRAJNER K.B. "S.SALIHAI"	044 967 703	/o	Salihaj
14	Resul Gashi	Qendra Rinore	044 718 654	gashiresul@gmail.com	Bashiqi
15	Kimete Ury	ZKF	044/436/455	kimete.ury@skc-qv.com.net	Ury
16	Fetkure Fetohi	DKRS	044/228-533	fetkurefetohi@skc-qv.com.net	Fetohi
17	Lemir Anas	DKRS	044/517/263	lemiranas@skc-qv.com	Anas
18					
19					
20					
21					



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic Of Kosovo**  
**Komuna Shtime / Opština Štimlje / Municipality Of Shtime**  
**Drejtoria Për Zhvillim Ekonomik**



/ Direktorat za Ekonomski Razvoj / Directorate for Economic Development

Nr. 04/15

Datë: 23.06.2020

### **Procesverbal**

#### **Tema e debatit publik “Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB) 2021-2023”**

Prezantimi i Drejtorit Për Zhvillim Ekonomik, Fitim Hoxha për “Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB) 2021-2023”:

Të nderuar përfaqësues të bizneseve në Shtime, të nderuar zyrtar komunal!

Sot kemi debatin publik për draft- dokumentin Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB) 2021-2023

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2021-2023

Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor.

Nga projektet e parashikuara në kornizën afatmesme buxhetore po shkëpusim projektet e drejtorisë për zhvillim ekonomik:

- Rregullimi i infrastrukturës në zonën ekonomike II
- Rregullimi i shtigjeve profesionale për çiklizëm dhe mootocros në zonat turistike
- Rregullimi i rrugëve bujqësore me zhavorr
- Projektet me participim për Zhvillim Ekonomik
- Rregullimi I parkut te pishave në Shtime
- Rregullimi I parkut sportiv në Mollopolc, Devetak, Llnisht
- Rregullimi i krojeve dhe burimeve të ujit në Zonat Turistike Llanisht, Rancë dhe Karaqicë

Të nderuar, faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj dhe ju ftojme që të kontribuoni me komente, rekomandime dhe sugjerimet.

Hap debatin për kornizë afatmesme buxhetore 2021-2022

Fjala e Behadin Rexhepit:

Zonat e biznesit të cilat shtrihen në rrugën në drejtim të Prishtinë-Lipjan nga dalija e Shtimës, kanë nevojë për:

- 1.Rregullimin e kanalizimit të ujërave atmosferike, ujërave të zeza dhe ujësjellsin
- 2.Rregullimin e trotuarit për kombësor dhe biçikleta
- 3.Për legalizimin e zonës për paisje me Licenca për ushtriminë e veprimtarive
- 4.Për shtrirjen e rrjetit telefon fiks
- 5.Për shtrirjen e rrjetit elektrik

Fjala e Hyzer Gashit:

Zona e Biznesëve që shtrihen në daljen nga qytetëza e Shtimës në drejtim të Ferizajit

- 1.Rregullimin e trotuarit deri në kufi administrativ të komunës së Ferizajit
- 2.Kanalizimin e ujërave atmosferike dhe ujërave të zeza si dhe ujësjellësin

### 3.Rregullimin e rrjetit elektrik dhe atij telefonik

Fjala e drejtorit Fitim Hoxha:

Të nderuar faleminderit për kontributin tuaj.

Me respekt!

Drejtori për Zhvillim Ekonomik


Fitim Hoxha

---

Adresa: Rr. "Tahir Sinani" Nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.

Tel.: +381290389016, Ext.: 227, Mob.: 044 733 362

Email: [fitim.hoxha@rks-gov.net](mailto:fitim.hoxha@rks-gov.net)



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA SHTIME**  
**OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**

**Drejtoria për Shërbime Publike**  
**Uprava za Javne Službe/Directorate of Public Service**

Date: 24.06.2020

**Diskutimi publik me përfaqësuesit e ndërmarrjeve KEDS, Pastërtia dhe Ujësjellësi për propozim buxhetin e vitit 2021**

Takimin e hapi Drejtori i DSHP-se Hamëz Tërshani

Zyrtarja kryesore financiare, Kimete Ukaj e prezantoi planifikimin e buxhetit për vitin 2021.

Fjala i kalohet përfaqësuesit të kompanisë "Pastërtia", z. Osman Muharremi i cili i falënderoi të pranishmit si dhe ka vërejtje për përgatitjen me tekniken e punës për të mbuluar shërbimin dhe ngritjen e cilësisë.

Sipas tij i duhet një auto fshesë për pastrimin e qytetit si dhe një automjeti 4-5 tonë me të cilat ai mendon se do të mund të realizonte punët në mënyrë me efikasë.

Kompania Pastërtia sipas drejtorit menagjues ka shpërndarë 700 kontejner mirëpo problem i vazhdueshëm është teknika për tërheqjen e mbeturinave për të cilën insiston që duhet të përkrahen që të mund ta blejnë këto automjet.

Përfaqësuesi i KEDS Lavdim Dedushi deklaroi se furnizimi me energji elektrike nuk parashihet të jete problem edhe për vitin e ardhshëm mirëpo pjesën e projekteve dhe investimet ata i kanë të centralizuara në qendër dhe dega në komune nuk është kompetente për ato projekte.

Ndërsa përfaqësuesi i kompanisë rajonale të ujësjellësit z. Sabri Qerkini pasi që i përshëndet të pranishmit në fjalën e tij ai deklaroi se komuna duhet që të investoj në rrjetin e ujësjellësit pasi që nga viti 2003 nuk janë bërë investime apo shpime të reja të puseve edhe

Ujësjiellësi i ka disa projekte te gatshme ndërsa ai i propozon dy projekte për mbështetje nga komuna te cilat janë:

- 1.Hapja e dy puseve te reja ne Rashince.
- 2.Si dhe dy puse te reja te shkolla e mesme “Naim Frasheri” në Shtime.

Këto projekte sipas tij kapnin vlerën monetare rreth 174.000 euro.

Gjithashtu edhe për fshatin Zborc një projekt për rregullimin rezervuarit i cili kushton rreth 30.000 euro.

Nuk ka pasur diskutime dhe propozime te tjera.

Ne fund drejtori i DSHP-se i ka falënderuar te pranishmit për pjesëmarrje.


Në këtë raport po i bashkëngjirim edhe disa foto te cilat janë bere gjate diskutimit me pjesëmarrësit.





---

Adresa: Rr. "Tahir Sinani", nr.50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.  
Tel.: +381290389016 ex 222 email: info@shtime-komuna.org  
<http://kk.rks-gov.net/shtime>



REPUBLIKA E KOSOVË  
KOMUNA SHITIME  
ZYRA E KRYETARIT  
SEKTORI PER FINANCA

Data: 24.06.20

Takim Pune – Njoftim për Debat Publike

Tema : Diskutim Publik Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023 për Komunën e Shtimes.

Lista e pjesëmarrësve në takim :

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nenshkrimi
1	OSMAN MUHAREMI	REKRETEKES KRM.P.	
2	HEROLIND SELMANI	2. PER KLIENIT KRM.P.	
3	LAVDIM DEGUSHI	ANALIST KEDS	
4	ADEM RAHMANI	KRYETAR, FSHANT RAÇAK	
5	SABRI GERIÇI	KOORDINATOR, XIJULI SHITIM	
6	Kimete Uroq	ZKF	
7	GOJART BAZRANU	ZEBENI	
8	Hanez Tefikani	PSHP	

## PROCESVERBAL

I mbajtur në Diskutimin Publik lidhur me Draft-Dokumentin Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale ( KAB ) 2021-2023, me Grupin e Interesit-Komuniteti Ashkali dhe Rom. Diskutimi Publik është mbajtur më 23.6.2020, nga ora 10;00-12;00.

Pjesëmarrës:


1. Ibrahim Demiri-shef I ZKKK-së
2. Rrahman Kadriu-kryesues I Komitetit për Komunitete
3. Albert Bajrami-kryetar i Forumit Rinor(FR)
4. Haxhi Behljuli-sekretar i FR
5. Xhemajl Jakupi-shoqëria civile ( OJQ )
6. Muhamet Mehmeti-shoqëria civile( OJQ )
7. Ardian Shabani-anëtar i FR
8. Egzonit Jakupi-OJQ
9. Behxhet Bajrushli-OJQ

Fillimisht, shefi i ZKKK, Ibrahim Demiri, ka njoftuar grupin me pikat e përgjithshme të Kornizës dhe pastaj ka veçuar Prioritetet në sektoret e caktuar që janë në interes të komuniteteve. Pjesëmarrësit në diskutim kanë kërkuar që ndër prioritetet të diskutohen dhe të propozohen këto rekomandime:

1. Në fshatin Gjyrkovc, te projektet kapitale-infrastrukturë, të përfshihet asfaltimi edhe i dy rrugëve “ Besim Sopa “ dhe “ Ulpiana “, që lidhin vendbanimet e komunitetit ashkali, në vitin 2021. Me përfundimin e këtyre rrugëve kompletohet edhe infrastruktura rrugore në fshatin Gjyrkovc, sa i përket komunitetit ashkali.
2. Në fund të rrugës “ Sami Frashëri “ dhe rrugës “ Hysiqi “, në Shtime, janë bërë vendbanime të reja ku janë ndërtuar rreth 15 shtëpi të komunitetit ashkali, shumica përmes donatorëve, të cilat kanë nevojë për rregullim të rrugës, kanalizim dhe ujësjellës. Shumica janë raste sociale. Rekomandohet që këto rrugë të përfshihet në Pozicionin ” Rregullimi i disa segmenteve të rrugëve dhe rrjetit të kanalizimit në Shtime”, edhe atë duke filluar në vitin 2021.
3. Gjithashtu rekomandohet që te Shërbimet Publike “ Rregullimi i rrugëve me zhavor”, të futen edhe disa rrugë bujqësore në fshatin Gjyrkovc dhe Vojnovc, pasi që komuniteti ashkali të vetmin burim jetese ka nga përfitimet nga bujqësia dhe pronat e tyre bujqësore.
4. Grupi i intereseti rekomandon në pozicionin subvencione për ZKKK-në nga viti 2021 të shtohet nga 6500 Euro në 9500 Euro dhe jo nga viti 2023 siqë është planifikuar, për shkakë se ZKKK-ja vazhdimisht ballafaqohet me kërkesa të shumta nga komunitetet Rom dhe Ashkali ne tushat e Strehimit, banimit, mirqenjes sociale, shendetesise dhe aktiviteteve rinore.  
Po ashtu ZKKK-ja ka për obligim zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve që dalin nga Plani Lokal Veprimi për Përfshirjen e Komuniteteve Ashkali dhe Rom në Komunën e Shtimës( të aprovuar nga Kuvendi) dhe të Strategjisë së QRK-së për Përfshirjen e Komuniteteve Ashkali dhe Rom në Shoqërin Kosovare 2017-2021.

Shtime: 23.6.2020

Procesmbajtës  
Egzonit Jakupi





6/24/2020

IMG\_9560.jpg



Lista e nënshkrimit të Grupit të Interesit-Komunitetit Ashkali dhe Rom në Diskutimin Publik lidhur me Draft-Dokumentin Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale ( KAB ) 2021-2023,  
 Diskutimi Publik është mbajtur më 23.6.2020, nga ora 10;00-12;00

Nr.	Emri & Mbiemri	Pozita	Nënshkrimi
1.	1. Ibrahim Demiri	Shef i ZKKK-së	<i>Ibrahim Demiri</i>
2.	2. Rrahman Kadriu	Kryesues i KPK-së	<i>Rrahman Kadriu</i>
3.	3. Albert Bajrami	Kryetar i Forumit Rinor	<i>A. Bajrami</i>
4.	4. Haxhi Behljuli	Sekretar i Forumit Rinor	<i>H. Behljuli</i>
5.	5. Xhemajl Jakupi	Shoqëri Civile	<i>X.H. Jakupi</i>
6.	6. Muhamet Mehmeti	Shoqëri Civile	<i>M. Mehmeti</i>
7.	7. Ardian Shabani	Shoqëri Civile	<i>A. Shabani</i>
8.	8. Egzonit Jakupi	Shoqëri Civile	<i>Egzonit Jakupi</i>
9.	9. Behxhet Bajrushli	Shoqëri Civile	<i>B. Bajrushli</i>